

L I G J
Nr. 8932, datë 25.7.2002

**PËR DËRGIMIN E NJË FORCE USHTARAKE SHQIPTARE NË AFGANISTAN,
NË KUADËR TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 9259, datë 15.7.2004; nr. 9752, datë 7.6.2007; nr. 10012, datë
30.10.2008)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 84 pika 4 të Kushtetutës,
me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :**

Neni 1

*(Ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 9259, datë 15.7.2004; ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 9752, datë
7.6.2007; ndryshuar me ligjin nr. 10012, datë 30.10.2008)*

Republika e Shqipërisë merr pjesë, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër
terrorizmit, në Afganistan, me një kompani, së bashku me elementet mbështetëse, një togë, së
bashku me elementet mbështetëse, një ekip mjekësor dhe një ekip trajnues (Operational
Mentoring Liaison Team, OMLT), efektivë të Forcave të Armatosura.

Neni 2

*(Ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 9259, datë 15.7.2004; ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 9752, datë
7.6.2007; shtuar togfjalësh me ligjin nr. 10012, datë 30.10.2008)*

Me vendim të Këshillit të Ministrave, ushtarakëve në përbërje të kompanisë, togës, ekipit
mjekësor dhe ekipit trajnues u përcaktohet gjatë ditëve të misionit, përveç pagës mujore dhe
vështirësisë së shërbimit, një shpërblim ditor, trajtim dhe përballim të shpenzimeve për
kompensimin e pasojave që vijnë për shkak të detyrës.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr. 3426, datë 7.8.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**